



Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, neni 37.2 nën paragrafi (c), neni 65.2, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe neni 6 dhe 7 të udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 24.12.2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z. MENSUR GRAJÇEVCI** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, nga subjekti politik "Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës- AAK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Betim Ahmeti.
- II. Obligohet Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, që ky vendim t'i komunikohet z. Mensur Grajçevci, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 13.12.2019, Nr.1934/2019, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z. Betim Ahmeti, nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye të pozitës së re, Sekretar në Shkollën "Dut Bugujevci" në Fushë Kosovë.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar, se kandidati i radhës në listën e rirenditur është z. Mensur Grajçevci, i cili ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidat i radhës, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 24.12.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka